



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 298/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 05.08.2020 shqyrtoi ankesën përkatësisht me:

Objekt:

“Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “4 S” sh.p.k. në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me nr. REF-53221-03-06-2020, me objekt Loti 3 “*Blerje mish dhe nënproduktet e tij*”, me fond limit 30.846.736 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 17.04.2020, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.”

Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “MC Catering” sh.p.k. në procedurën e mësipërme të prokurimit.”

Ankimues:

Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Argent Daci” p.f. & “Bioproducts” sh.p.k.
Godina nr.21, poshtë kthesës së Valiasit, Kamëz, Tiranë

“MC Catering” sh.p.k.
Rruga “Pjetër Budi”, Nd.29, H.3, Ap.14, Nj.Adm. Nr.2, 1010, Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Agjencia e Blerjeve të Përqendruara
Sheshi Skënderbej, Nr.3, Tiranë

Subjekte të interesuar: “4 S” sh.p.k.
Lagja “Xhevdet Nepravishta”, Rruga “Çajupi”, godina 1 katëshe,
mbrapa shkollës “Liri Kazazi”, Nr.199, Lushnje

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.2. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas kanë paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 09.03.2020, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, me nr. REF-53221-03-06-2020, me objekt Loti 3 “Blerje mish dhe nënproduktet e tij”, me fond limit 30.846.736 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 17.04.2020, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

II.2. Në datën 17.04.2020, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 01.05.2020 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “MC Catering” sh.p.k.	21.148.140 lekë, skualifikuar
2. “Tona” sh.p.k.	23.469.215 lekë, skualifikuar
3. “4 S” sh.p.k.	24.778.100 lekë, kualifikuar
4. BOE “Argent Daci” p.f. & “Bioproducts” sh.p.k.	24.960.910 lekë, skualifikuar
5. BOE “Kazazi Meat” sh.p.k. & “Nelsa” sh.p.k.	25.334.830 lekë, skualifikuar
6. “Kazazi Meat” sh.p.k.	25.723.030 lekë, skualifikuar
7. “Nika” sh.p.k.	26.801.900 lekë, skualifikuar
8. “In -Ma” sh.p.k.	Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike
9. “Gerti - 1987” sh.p.k.	Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike

II.4. Në datën 01.05.2020 bashkimi i operatorëve ekonomikë “Argent Daci” p.f. & “Bioproducts” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi, për arsyet si më poshtë vijon:

- Anëtari i BOE “BioProduct” shpk skualifikohet pasi nuk përmbush kriterin e përcaktuar në pikën 1, gërma “f” të kriterëve të veçanta për kualifikim të dokumentave të tenderit, duke mos arritur të vërtetojë se ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike.
- Anëtari i BOE “BioProduct” shpk, në bazë të përqindjes së kontratës së bashkëpunimit, nuk përmbush kriterin e përcaktuar në pikën 1 të kapacitetit ekonomik dhe financiar, pasi nga vertetimi i paraqitur për përmbushjen e këtij kriteri xhiroja mesatare për tre vitet e fundit nuk kap vlerën mesatare jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të këtij Loti.
- Anëtari i BOE “BioProduct” shpk, në bazë të përqindjes së kontratës së bashkëpunimit nuk përmbush kriterin e përcaktuar në pikën 1 të Kapacitetit Teknik të kriterëve të veçanta të kualifikimit, pasi nga dokumentacioni i paraqitur nuk arriti të provojë se ka realizuar furnizime të ngjashme në raport me vlerën të paktën 40 % të fondit limit të loti.

II.4.1. Në datën 07.05.2020 bashkimi i operatorëve ekonomikë “Argent Daci” p.f. & “Bioproducts” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së tij ekonomike. Gjithashtu, bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimes ngre pretendime mbi kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “4 S” sh.p.k. në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi. Konkretisht, bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimes në ankesën e tij pranë autoritetit kontraktor ka kërkuar në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

[...]

1. *Pezullimin e vazhdimin të procedurës së prokurimit me objekt: Loti 3 – “Blerje mish dhe nënproduktet e tij”, me fond limit: 30,846,736 (tridhjetë milion e tetëqind e dyzetë e gjashtë mijë e shtatëqind e tridhjetë e gjashtë) lekë (pa Tvsh).*

2. *Rishqyrtimin e dokumentave të paraqitura nga BOE midis “Argent Daci” dhe “Bioproducts” sh.p.k.*
3. *Skualifikimin e operatorit ekonomik “4 S” sh.p.k.*
4. *Kualifikimin dhe shpalljen fitues të BOE “Argent Daci” dhe “Bioproducts” sh.p.k.*

II.4.2. Referuar dokumentacionit bashkëlidhur ankesës së bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues ky i fundit pretendon se në datë 16.05.2020 ka marrë dënimin, në lidhje me shkresën e autoritetit kontraktor nr.711/1 prot, 712/1, 713/1, 714/1, 715/1 datë 13.05.2020 me objekt “Njoftim mbi pezullimin e afatit të shqyrtimit dhe marrjes së vendimit përfundimtar mbi ankesën”, me përmbajtje si më poshtë:

[...]

...Për sa më sipër, në zbatim të nenit 63 të LPP-së dhe nenit 78 të RPP-së, me marrjen e ankesave tuaja, me datë 07.05.2020, organi qendror blerës ka pezulluar vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesat të shqyrtohen plotësisht nga komisioni i shqyrtimit të ankesave (KSHA), përfshirë dhe nxjerrjen e vendimeve brenda 7 ditëve nga data e depozitimit të tyre.

Duke qenë se gjatë shqyrtimit administrativ të ankesave ne organin qendror blerës, jemi perballur me “çështjen paraprake” për të cilën është kompetente një strukturë tjetër, zgjidhja e së cilës është parakusht për marrjen e një vendimi përfundimtar nga KSHA, afati kohor 7 ditor është ndërprerë me datë 13.05.2020 dhe do të rifillojë përsëri, pasi të dërgohet zyrtarisht vendimi i organit tjetër publik pranë organit qendror blerës ABP, bazuar në nenin 66 e në vijim të Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe legjislacionin në fuqi për prokurimit publik. Më konkretisht, përpara se KSHA në organin qendror blerës, të marrë një vendim përfundimtar të arsyetuar mbi pretendimet tuaja, në zbatim mbështetje të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 45, ju njoftojmë se afati 7 ditor për shqyrtimin dhe marrjen e vendimit mbi ankesën tuaj, është pezulluar dhe do të rifillojë pas marrjes zyrtarisht përgjigjes nga autoriteti publik kompetent.

II.4.3. Në datën 22.05.2020, me shkresën nr. 711/4 prot. dhe 711/3 prot, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues duke e refuzuar ankesën e tij në lidhje me procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.4.4. Në datën 02.06.2020 bashkimi i operatorëve ekonomikë “Argent Daci” p.f. & “Bioproducts” sh.p.k. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik duke pretenduar në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

[...]

1. *Skualifikimin e operatorit ekonomik “4S” sh.p.k. për mosplotësim të kriterëve të vecanta të kualifikimit;*
2. *Anulimin e procedurës së prokurimit dhe përsëritjen e saj.*

II.5. Në datën 01.05.2020 operatori ekonomik “MC Catering” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi, për arsyet si më poshtë vijon:

- *Operatori ekonomik nuk përmbush kriterin e përcaktuar në pikën 4 të Kapacitetit teknik, pasi nuk arriti të vertetojë se ka në pronësi ose në përdorim 1 (një) ambient të përshtatshëm për*

përpunimin ose tregtimin ose magazinimin e produkteve të mishit/ të përpunuara të mishit objekt prokurimi, me sipërfaqe të paktën 50 m2. Akt marrëveshja me nr. Repertori; 434, nr.koleksioni 97 e datës 20/03/2020 e lidhur me subjektin “Ismet Darsi” pf, kur ky i fundit nuk është deklaruar si nënkontraktor nga ofertuesi si dhe nuk ka as marrëveshje bashkëpunimi të përkohshëm midis ofertuesit “M.C Catering” SHPK dhe “Ismet Darsi” pf nuk mund të konsiderohet si dokument i vlefshëm për përmbushjen e kriterit. Gjithashtu sqarojmë se ambjenti për të cilin janë paraqitur dokumentet; Akt miratimi higjeno – sanitar për këtë ambient, lëshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj,dhe foto të ambientit të brendshëm të prodhimit ose magazinimit të mallrave objekt prokurimi disponohet nga “Ismet Darsi” pf dhe jo nga ofertuesi “M.C Catering” SHPK. Kontrata e furnizimit me nr. Repertori; 256, nr.koleksioni 131 e datës 19/01/2018 e lidhur me subjektin “Agro Progres” shpk, kur ky i fundit nuk është deklaruar si nënkontraktor nga ofertuesi si dhe nuk ka as marrëveshje bashkëpunimi të përkohshëm të operatorëve ekonomik midis ofertuesit “M.C Catering” SHPK dhe “Agro Progres” shpk nuk mund të konsiderohet si dokument i vlefshëm për përmbushjen e kriterit. Gjithashtu sqarojmë se ambjenti për të cilin janë paraqitur dokumentet; Akt miratimi higjeno – sanitar për këtë ambient, lëshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj,dhe foto të ambientit të brendshëm të prodhimit ose magazinimit të mallrave objekt prokurimi disponohet nga “Agro Progres” shpk dhe jo nga ofertuesi “M.C Catering” SHPK.

Kontrata e bashkëpunimit me nr. Repertori; 259, nr.koleksioni 134 e datës 19/01/2018 e lidhur me subjektin “KELVIS 2013” shpk, kur ky i fundit nuk është deklaruar si nënkontraktor nga ofertuesi si dhe nuk ka as marrëveshje bashkëpunimi të përkohshëm të operatorëve ekonomik midis ofertuesit “M.C Catering” SHPK dhe “Kelvis 2013” shpk nuk mund të konsiderohet si dokument i vlefshëm për përmbushjen e kriterit. Gjithashtu sqarojmë se ambjenti për të cilin janë paraqitur dokumentet; Akt miratimi higjeno – sanitar për këtë ambient, lëshuar nga organi kompetent i ngarkuar me ligj,dhe foto të ambientit të brendshëm të prodhimit ose magazinimit të mallrave objekt prokurimi disponohet nga “Kelvis 2013” shpk dhe jo nga ofertuesi “M.C Catering” SHPK.

- *Operatori ekonomik nuk ka paraqitur deklarata të ku të listohen dokumentet e paraqitura në përmbushje të kriterëve kumulative për Lotin konkret.*

II.5.1. Në datën 07.05.2020 operatori ekonomik “MC Catering” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së tij ekonomike. Konkretisht, bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues në ankesën e tij pranë autoritetit kontraktor ka kërkuar në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

[...]

Kërkojmë nga ju si AK, marrjen parasysh të kërkesës tone dhe rikuotimin e ri të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës duke kualifikuar shoqërinë “MC Catering” sh.p.k. si ofertën më të leverdisshme.

II.5.2. Referuar dokumentacionit bashkëlidhur ankesës së operatorit ekonomik ankimues ky i fundit pretendon se në datë 13.05.2020 ka marrë dijeni me anë të postës elektronike dhe më pas në datë 16.05.2020 me anë të shërbimit postar, në lidhje me shkresën e autoritetit kontraktor nr.702/1 prot, 706/1, 719/1 datë 13.05.2020 me objekt “Njoftim mbi pezullimin e afatit të shqyrtimit dhe marrjes së vendimit përfundimtar mbi ankesën”, me përmbajtje si më poshtë:

[...]

...Për sa më sipër, në zbatim të nenit 63 të LPP-së dhe nenit 78 të RPP-së, me marrjen e ankesave tuaja, me datë 13.05.2020, organi qendror blerës ka pezulluar vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesat të shqyrtohen plotësisht nga komisioni i shqyrtimit të ankesave (KSHA), përfshirë dhe nxjerrjen e vendimeve brenda 7 ditëve nga data e depozitimit të tyre.

Duke qenë se gjatë shqyrtimit administrativ të ankesave ne organin qendror blerës, jemi perballur me “çështjen paraprake” për të cilën është kompetente një strukturë tjetër, zgjidhja e së cilës është parakusht për marrjen e një vendimi përfundimtar nga KSHA, afati kohor 7 ditor është ndërprerë me datë 13.05.2020 dhe do të rifilloje përsëri, pasi të dërgohet zyrtarisht vendimi i organit tjetër publik pranë organit qendror blerës ABP, bazuar në nenin 66 e në vijim të Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe legjislacionin në fuqi për prokurimit publik. Më konkretisht, përpara se KSHA në organin qendror blerës, të marrë një vendim përfundimtar të arsyetuar mbi pretendimet tuaja, në zbatim mbështetje të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 45, ju njoftojmë se afati 7 ditor për shqyrtimin dhe marrjen e vendimit mbi ankesën tuaj, është pezulluar dhe do të rifillojë pas marrjes zyrtarisht përgjigjes nga autoriteti publik kompetent.

II.5.3. Në datën 22.05.2020, me shkresën nr. 702/4 prot. dhe 702/3 prot, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues duke e refuzuar ankesën në lidhje me procedurën e mësipërme të prokurimit. Ndërkohë që operatorit ekonomik ankimues, pretendon se ka marrë dijeni në lidhje me refuzimin e ankesës së tij, në datë 28.05.2020.

II.5.4. Në datën 05.06.2020 operatorit ekonomik “MC Catering” sh.p.k. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik duke ngritur të njëjtat pretendime si në ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.6. Nëpërmjet shkresës nr. 1017/1 prot., datë 12.06.2020, protokolluar me tonën në datën 17.06.2020 me objekt: “Dërgim dokumentacioni për Lotin 3: “Blerje mish dhe nënproduktet e tij” për procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje artikuj ushqimorë, për autoritetet kontraktore të qarkut Tiranë”, e ndarë në 7 (shtatë) Lote”; shkresës nr. 1017/2 prot., datë 29.06.2020, protokolluar me tonën në datën 03.07.2020 me objekt: “Dërgim dokumentacioni për Lotin 3: “Blerje mish dhe nënproduktet e tij” për procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje artikuj ushqimorë, për autoritetet kontraktore të qarkut Tiranë”, e ndarë në 7 (shtatë) Lote”; shkresës nr. 1397 prot., datë 13.07.2020, protokolluar me tonën në datën 15.07.2020 me objekt: “Plotësim dokumentacioni për Lotin 3: “Blerje mish dhe nënproduktet e tij” për procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje artikuj ushqimorë, për autoritetet kontraktore të qarkut Tiranë”, e ndarë në 7 (shtatë) Lote”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesave të operatorëve ekonomikë ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të operatorëve ekonomikë ankimues, (thema decidendum) në zbatim të nenit 30 pika 2 të Vendimit nr.596/2018, datë 12.09.2018 të Komisionit të Prokurimit Publik *“Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik, në të cilin parashikohet se “Komisioni shqyrton ankesën brenda objektit dhe shkaqeve të parashtruara në ankesë. 2. Përjashtimisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre”*, referuar materialeve të administruara në fashikullin e shqyrtimit administrativ, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të ndalet fillimisht në ligjshmërinë e veprimeve të autoritetit kontraktor, për sa kohë që objekti i ankesave ka lidhje me vendimet dhe veprimet e tjera të autoritetit kontraktor gjatë zbatimit të hapave të mëtejshëm të procedurës së prokurimit objekt ankimi. Akoma më tej, referuar nenit 64 pika 3 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”* të ndryshuar, parashikohet se: *“3. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik, kur gjykon se një vendim apo veprim i autoritetit kontraktor ka shkelur ndonjë nga dispozitat e këtij ligji, ka të drejtë:*

a) të nxjerrë një interpretim për rregullat ose parimet ligjore, që duhet të zbatohen për objektin e ankesës;

b) të anulojë, plotësisht ose pjesërisht, një veprim ose vendim të autoritetit kontraktor, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin. Kjo përfshin edhe të drejtën për të hequr të gjitha ato specifikime teknike ose llojet e tjera të specifikimeve që bien ndesh me këtë ligj;

c) të udhëzojë autoritetin kontraktor të korrigjojë shkeljet dhe më pas të vazhdojë me procedurën e prokurimit të kontratës;

ç) të urdhërojë anulimin e procedurave për shpalljen e kontratës fituese”.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se:

III.1.1. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 01.05.2020 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “MC Catering” sh.p.k.	21.148.140 lekë, skualifikuar
2. “Tona” sh.p.k.	23.469.215 lekë, skualifikuar
3. “4 S” sh.p.k.	24.778.100 lekë, kualifikuar
4. BOE “Argent Daci” p.f. & “Bioproducts” sh.p.k.	24.960.910 lekë, skualifikuar
5. BOE “Kazazi Meat” sh.p.k. & “Nelsa” sh.p.k.	25.334.830 lekë, skualifikuar
6. “Kazazi Meat” sh.p.k.	25.723.030 lekë, skualifikuar
7. “Nika” sh.p.k.	26.801.900 lekë, skualifikuar
8. “In -Ma” sh.p.k.	Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike

III.1.2. Në datën 07.05.2020 bashkimi i operatorëve ekonomikë “Argent Daci” p.f. & “Bioproducts” sh.p.k., në respekt të nenit 63 pika 2 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së tij ekonomike, si dhe duke ngritur pretendime mbi kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “4 S” sh.p.k. në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi. Gjithashtu, në datën 07.05.2020 operatori ekonomik “MC Catering” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së tij ekonomike.

III.1.3. Referuar dokumentacionit bashkëlidhur ankesës së bashkimi i operatorëve ekonomikë “Argent Daci” p.f. & “Bioproducts” sh.p.k. ky i fundit pretendon se në datë 16.05.2020 ka marrë dijëni, në lidhje me shkresën e autoritetit kontraktor nr.711/1 prot, 712/1, 713/1, 714/1, 715/1 datë 13.05.2020 me objekt “Njoftim mbi pezullimin e afatit të shqyrtimit dhe marrjes së vendimit përfundimtar mbi ankesën”, me anë të së cilës autoriteti kontraktor ka njoftuar bashkimin e operatorëve ekonomikë ankimes mbi pezullimin e afatit të shqyrtimit të ankesës dhe marrjes së vendimit përfundimtar mbi ankesën e tij. Referuar aktit të mësipërm, KPP konstaton se autoriteti kontraktor ndër të tjera ka argumentuar se: “...Për sa më sipër, në zbatim të nenit 63 të LPP-së dhe nenit 78 të RPP-së, me marrjen e ankesave tuaja, me datë 07.05.2020, organi qendror blerës ka pezulluar vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesat të shqyrtohen plotësisht nga komisioni i shqyrtimit të ankesave (KSHA), përfshirë dhe nxjerrjen e vendimeve brenda 7 ditëve nga data e depozitimit të tyre. Duke qenë se gjatë shqyrtimit administrativ të ankesave ne organin qendror blerës, jemi perballur me “çështjen paraprake” për të cilën është kompetente një strukturë tjetër, zgjidhja e së cilës është parakusht për marrjen e një vendimi përfundimtar nga KSHA, afati kohor 7 ditor është ndërprerë me datë 13.05.2020 dhe do të rifillojë përsëri, pasi të dërgohet zyrtarisht vendimi i organit tjetër publik pranë organit qendror blerës ABP, bazuar në nenin 66 e në vijim të Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe legjislacionin në fuqi për prokurimit publik. Më konkretisht, përpara se KSHA në organin qendror blerës, të marrë një vendim përfundimtar të arsyetuar mbi pretendimet tuaja, në zbatim mbështetje të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 45, ju njoftojmë se afati 7 ditor për shqyrtimin dhe marrjen e vendimit mbi ankesën tuaj, është pezulluar dhe do të rifillojë pas marrjes zyrtarisht përgjigjes nga autoriteti publik kompetent”.

Gjithashtu, referuar dokumentacionit bashkëlidhur ankesës së operatorit ekonomik “MC Catering” sh.p.k., ky i fundit pretendon se në datë 13.05.2020 ka marrë dijëni me anë të postës elektronike dhe më pas në datë 16.05.2020 me anë të shërbimit postar, në lidhje me shkresën e autoritetit kontraktor nr.702/1 prot, 706/1, 719/1 datë 13.05.2020 me objekt “Njoftim mbi pezullimin e afatit të shqyrtimit dhe marrjes së vendimit përfundimtar mbi ankesën”, me anë të së cilës autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorin ekonomik ankimes mbi pezullimin e afatit të shqyrtimit të ankesës dhe marrjes së vendimit përfundimtar mbi ankesën e tij.

III.1.4. Në datën 22.05.2020, me shkresën nr. 711/4 prot. dhe 711/3 prot, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje bashkimit të operatorëve ekonomikë “Argent Daci” p.f. & “Bioproducts” sh.p.k., duke e refuzuar ankesën në lidhje me procedurën e mësipërme të prokurimit.

Gjithashtu, në datën 22.05.2020, me shkresë nr. 702/4 prot. dhe 702/3 prot, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik “MC Catering” sh.p.k. duke e refuzuar ankesën në lidhje

me procedurën e mësipërme të prokurimit. Ndërkohë që operatori ekonomik ankimues “MC Catering” sh.p.k., pretendon se ka marrë dizeni në lidhje me refuzimin e ankesës së tij, në datë 28.05.2020.

III.1.5. Referuar materialeve të administruar në fashikullin e shqyrtimit administrativ, KPP konstaton se, bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues “Argent Daci” p.f. & “Bioproducts” sh.p.k. dhe operatori ekonomik “MC Catering” sh.p.k. kanë ushtruar të drejtën e tyre të ankimit të vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, pranë autoritetit kontraktor. Gjithashtu, rezulton se bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues “Argent Daci” p.f. & “Bioproducts” sh.p.k. dhe operatori ekonomik ankimues “MC Catering” sh.p.k. kanë paraqitur ankesa pranë Komisionit të Prokurimit Publik me anë të së cilave kanë kundërshtuar vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave në lidhje me pretendimet e këtyre të fundit. Gjithashtu, në nenin 30 pika 2 të Vendimi nr. 596/2018 datë 12.09.2018 Komisionit të Prokurimit Publik *“Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik, në të cilin parashikohet se “Komisioni shqyrton ankesën brenda objektit dhe shkaqeve të parashtruara në ankesë. 2. Përgjashtimisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre”*.

Në rastin konkret, KPP gjykon të ndalet fillimisht në lidhje me natyrën e afateve të shqyrtimit të ankesave të parashikuara në nenin 63 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”* të ndryshuar.

III.1.6. Referuar materialeve të administruar në fashikullin e shqyrtimit administrativ, Komisioni i Prokurimit Publik, para shqyrtimit në themel të pretendimeve të bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Argent Daci” p.f. & “Bioproducts” sh.p.k. dhe operatorit ekonomik ankimues “MC Catering” sh.p.k., *prima facia* konstaton se referuar shkresës nr.711/1 prot, 712/1, 713/1, 714/1, 715/1 datë 13.05.2020 dhe shkresës nr.702/1 prot, 706/1, 719/1 datë 13.05.2020, autoriteti kontraktor ka njoftuar bashkimin e operatorëve ekonomikë ankimues “Argent Daci” p.f. & “Bioproducts” sh.p.k. dhe operatorin ekonomik ankimues “MC Catering” sh.p.k., mbi pezullimin e afatit të shqyrtimit të ankesave dhe marrjes së vendimit përfundimtar mbi ankesat. *Inter alia*, autoriteti kontraktor është shprehur se *“[...] Duke qenë se gjatë shqyrtimit administrativ të ankesave ne organin qendror blerës, jemi perballur me “çështjen paraprake” për të cilën është kompetente një strukturë tjetër, zgjidhja e së cilës është parakusht për marrjen e një vendimi përfundimtar nga KSHA, afati kohor 7 ditor është ndërprerë me datë 13.05.2020 dhe do të rifillojë përsëri, pasi të dërgohet zyrtarisht vendimi i organit tjetër publik pranë organit qendror blerës ABP, bazuar në nenin 66 e në vijim të Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe legjislacionin në fuqi për prokurimit publik. Më konkretisht, përpara se KSHA në organin qendror blerës, të marrë një vendim përfundimtar të arsyetuar mbi pretendimet tuaja, në zbatim mbështetje të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 45, ju njoftojmë se afati 7 ditor për shqyrtimin dhe marrjen e vendimit mbi ankesën tuaj, është pezulluar dhe do të rifillojë pas marrjes zyrtarisht përgjigjes nga autoriteti publik kompetent”, KPP nënvizon se në respekt të nenit 64 pika 3 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”* të ndryshuar, parashikohet se: *“3. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik, kur gjykon se një vendim apo veprim i autoritetit kontraktor ka shkelur ndonjë nga dispozitat e këtij ligji, ka të drejtë: a) të nxjerrë një interpretim**

për rregullat ose parimet ligjore, që duhet të zbatohen për objektin e ankesës; b) të anulojë, plotësisht ose pjesërisht, një veprim ose vendim të autoritetit kontraktor, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin. Kjo përfshin edhe të drejtën për të hequr të gjitha ato specifikime teknike ose llojet e tjera të specifikimeve që bien ndesh me këtë ligj;”

Sa më sipër, KPP vlerëson të ndalet fillimisht në respektimin e afateve të shqyrtimit të ankesave, e cila është lidhur drejtpërdrejtë me pas me datën dhe afatin e dorëzimit të ankesave pranë Komisionit të Prokurimit Publik nga ana e operatorëve ekonomikë ankimues. Në rastin konkret, KPP sqaron se në nenin 63, pika 1, 2, 5 dhe 6, të ligjit nr.9643, dt.20.11.2006 “Për prokurimin publik” është parashikuar: “Çdo person që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.” “Ankesa i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji.” “Autoriteti kontraktor shqyrton ankesën dhe merr një vendim të arsyetuar brenda 7 ditëve pas marrjes së ankesës, të cilin duhet t’ia njoftojë ankuesit jo më vonë se në ditën vijuese të punës”. Ndërsa në pikën 6 të kësaj dispozite është përcaktuar se: “Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor.”

Në kreun X “Shqyrtimi i Ankesave”, neni 78, pika 6 i Vendimit nr.914 të Këshillit të Ministrave datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar parashikohet se “Për shqyrtimin e ankesave, autoriteti kontraktor ndjek hapat e mëposhtëm: a) Titullari i autoritetit kontraktor ia ngarkon çështjen një komisioni të përbërë nga 3 (tre) persona, për të shqyrtuar ankesën dhe për të dhënë një vendim. Përyjetimisht, në rast të mungesës së personelit, titullari i autoritetit kontraktor ia ngarkon çështjen për shqyrtim 1 (një) zyrtari të vetëm. Komisioni/zyrtari i ngarkuar është përgjegjës për vendimin e dhënë në përfundim të shqyrtimit të ankesës. Anëtarët e komisionit/zyrtari i ngarkuar nuk duhet të kenë marrë pjesë në marrjen e vendimit, për të cilin është paraqitur ankesa. Në rast se ankimi lidhet me dokumentet e tenderit, titullari i autoritetit kontraktor mund t’ia ngarkojë shqyrtimin e ankesës komisionit të vlerësimit të ofertave.” Në nenin 78, pika 6 gërma “ç” të Vendimit Nr.914 të Këshillit të Ministrave dt.29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet se : [...].

III.1.7. KPP konstaton se ligjvënësi ka parashikuar afate strikte kohore për zhvillimin e procedurave të prokurimit në përgjithësi dhe në veçanti në lidhje me institutin e ankimit administrativ, të rishikimit të vendimarrjes së autoritetit kontraktor. Konkretisht, është parashikuar se ankesa paraqitet në autoritetin kontraktor brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji. Njëkohësisht ligji si edhe aktet nënligjore kanë parashikuar afatet e shpejta proceduriale mbi veprimet e autoritetit kontraktor pas marrjes dhe administrimit të ankesës, për rrjedhojë në nivel ligji është parashikuar se Autoriteti kontraktor shqyrton ankesën dhe merr një vendim të arsyetuar brenda 7 ditëve pas marrjes së ankesës, të cilin duhet t’ia njoftojë ankuesit jo më vonë se në ditën vijuese të punës. Ky afat, lidhet gjithashtu edhe me afatin tjetër procedural, atë të

lindjes të së drejtës për ankim administrativ kundër vendimarrjes së shprehur të autoritetit kontraktor, ose edhe në rastet kur autoriteti kontraktor nuk shprehet me vendim pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Ky afat nis menjëherë nga e nesërme e punës kur ka përfunduar afati i trajtimit të ankesës nga ana e autoritetit kontraktor dhe përfundon në ditën e dhjetë. Komisioni sqaron se shqyrtimi administrativ i nënshtrohet dy fazave: asaj të shqyrtimit paraprak (në të cilin vlerësohen forma e ankimit, legjitimitimi, juridiksioni, kompetenca dhe nuk i jepet zgjidhje në thelb ankimit) dhe asaj të shqyrtimit në themel të ankimit (Nëse kërkesa përmbush elementet formale, Komisioni vazhdon me shqyrtimin në themel të saj). Konkretisht, Komisioni i Prokurimit Publik se doktrina dhe legjislacioni ynë i dallon afatet ligjore (ndër të tjera) si afate prekluzive – në përfundim të të cilëve shuhet e drejta e një subjekti për të kërkuar një të drejtë, apo e drejta e një organi për të ushtruar një pushtet (p.sh. të marrë një vendim në kompetencë të tij) dhe afate indikative – të cilët janë cilësuar nga legjislatori për të disiplinuar një marrëdhënie të caktuar, por që nuk kanë efekt represiv/prerës në lidhje me të drejtat e parashtruara. Është e vërtetë se Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” parashikon një afat 15 ditor për KPP që të shprehet me vendim mbi një ankim të paraqitur pranë saj (“...Me marrjen e ankesës me shkrim të ankimesit, Komisioni i Prokurimit Publik përgjigjet me shkrim lidhur me përmbushjen e elementeve formale të ankimit, brenda 5 ditëve, duke filluar nga dita e nesërme e punës. Kur për shqyrtimin e ankesës i kërkohet informacion apo dokumentacion autoritetit kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik merr vendim, jo më vonë se 15 ditë pas marrjes së informacionit apo dokumentacionit të kërkuar..”), po aq sa është e vërtetë se as ky ligj, as ndonjë legjislacion tjetër me ndikim mbi çështjen nuk ka përcaktuar se vendimet e KPP të dala përtej këtij afati kohor janë absolutisht apo relativisht të pavlefshme. Gjithashtu, për analogji, afati i shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave është paraparë si një afat indikativ, i cili mund pezullohet dhe konkretisht rregullohet shprehimisht në akt nënligjor, në nenin 66 pika 2 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar ku parashikohet se: “Kohëzgjatja e procedurës së vlerësimit nuk duhet të kalojë 15 (pesëmbëdhjetë) ditë, përveç rasteve të tjera të cilësuar ndryshe në këto rregulla. Në rast se komisionit të vlerësimit të ofertave i lind nevoja për verifikime ose ndryshime të një apo më shumë anëtarëve, afati i vlerësimit pezullohet në momentin e paraqitjes së kërkesës për verifikim apo ndryshim dhe rifillon aty ku është pezulluar me marrjen e përgjigjes apo zyrtarizimit të anëtarit/anëtarëve.” Si afat indikativ ai mund të ndërpritet si edhe mund të rivendoset, ndërkohë në asnjë rast afati mbi shqyrtimin e ankesave, referuar ligjit në fuqi nuk mund të ndërpritet. Për analogji, vërejmë se Kodi i Procedurës Civile, nenet 145 e 146, shprehen qartë se afatet janë prekluzive vetëm kur kjo parashikohet me ligj, përndryshe afatet janë të zakonshme, ku parashikohet se: Neni 145 “Afatet për kryerjen e veprimeve procedurale caktohen nga ligji dhe kur ky e lejon edhe nga gjykata. Afatet mund të jenë edhe prekluzive kur ligji e parashikon shprehimisht. Neni 146 Afatet e vendosura nga ligji janë të zakonshme, përveç kur ligji e parashikon shprehimisht se janë të prera. Afatet e prera nuk mund të shkurtohen ose të shtyhen, qoftë edhe me pëlqimin e palëve.” Në rastin konkret, KPP gjykon se ligjvënësi ka ndarë qartësisht dy momente, afatin e shqyrtimit të ankesave nga ana e autoritetit kontraktor si një afat prekluziv, me kalimin e të cilit shuhet e drejta e organit për t’u shprehur me vendim dhe lind e drejta e ankimit të operatorit ekonomik ankimes pranë Komisionit të Prokurimit Publik si edhe afateve të tjera indikative si afati i shqyrtimit të ankesave pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe afati i vlerësimit të ofertave pranë autoritetit kontraktor. Këto afate, (ai i shqyrtimit të ankesave) duke

qenë afate prekluzive nuk mund të ndërpriten apo të rivendosen, ndërkohë që autoriteti kontraktor referuar shkresës nr.711/1 prot, 712/1, 713/1, 714/1, 715/1 datë 13.05.2020 dhe shkresës nr.702/1 prot, 706/1, 719/1 datë 13.05.2020 ka njoftuar bashkimin e operatorëve ekonomikë ankimues “Argent Daci” p.f. & “Bioproducts” sh.p.k. dhe operatorin ekonomik ankimues “MC Catering” sh.p.k. mbi ndërprerjen e afateve të shqyrtimit të ankesave të tyre. Referuar akteve të mësipërme, KPP konstaton se autoriteti kontraktor ndër të tjera ka argumentuar se: “ [...Omissis...] Duke qenë se gjatë shqyrtimit administrativ të ankesave në organin qendror blerës, jemi perballur me “çështjen paraprake” për të cilën është kompetente një strukturë tjetër, zgjidhja e së cilës është parakusht për marrjen e një vendimi përfundimtar nga KSHA, afati kohor 7 ditor është ndërprerë me datë 13.05.2020 dhe do të rifillojë përsëri, pasi të dërgohet zyrtarisht vendimi i organit tjetër publik pranë organit qendror blerës ABP, bazuar në nenin 66 e në vijim të Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe legjislacionin në fuqi për prokurimit publik. Më konkretisht, përpara se KSHA në organin qendror blerës, të marrë një vendim përfundimtar të arsyetuar mbi pretendimet tuaja, në zbatim mbështetje të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 45, ju njoftojmë se afati 7 ditor për shqyrtimin dhe marrjen e vendimit mbi ankesën tuaj, është pezulluar dhe do të rifillojë pas marrjes zyrtarisht përgjigjes nga autoriteti publik kompetent”. Gjithashtu, në nenin 54 të Kodit të Procedurave Administrative parashikohet se: “Përveçse kur ndalohet shprehimisht me ligj, pala mund të kërkojë rivendosjen në afat, nëse është penguar për shkaqe të arsyeshme për respektimin e afatit procedural, me përjashtim të rasteve kur afatet kanë karakter prekluziv.” Sa më sipër, vetë Kodi i Procedurave Administrative parashikon se ndalohet rivendosja në afat në rastin kur afatet kanë karakter prekluziv si edhe në rastin e afateve të ankimit.

Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin se, përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimit etj, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga *lex specialis* LPP, në nenin 2 të tij, janë ato të mos diskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementëve të mësipërm lidhet ngushtësisht me elementë të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike.

Akoma më tej, referuar materialeve të administruara në fashikullin e shqyrtimit administrativ, KPP konstaton se ndërprerja e afateve nga ana e autoritetit kontraktor është mbështetur në nenin 66 pika 1 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” i cili parashikon se “Nëse organi publik që zhvillon procedurën përballë me një çështje, zgjidhja e së cilës është parakusht për zgjidhjen e procedurës dhe që përbën një çështje ligjore të pavarur, për zgjidhjen e së cilës është kompetent një gjykatë ose organ tjetër (“çështja paraprake”), organi publik që zhvillon procedurën administrative pezullon procedurën deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë për çështjen paraprake dhe njofton palën në lidhje me këtë”.

Në interpretim literal, sistematik dhe teologjik me synim vendosjen në pah të *ratio legis*, mbështetur edhe në parimin e e së drejtës se *ratio legis est anima legis*, (qëllimi i ligjit është edhe shpirti i ligjit), qëllimi i pezullimit të shqyrtimit të çështjeve lidhet me një çështje të pavarur ligjore, zgjidhja e së cilës i atribuohet një organi administrativ ose gjykatës. Ndërkohë, në rastin konkret KPP vlerëson se nuk ndodhemi para një çështje të pavarur ligjore siç mund të ishte një hetim administrativ i nisur nga një organ tjetër i administratës publike ose një çështje tjetër gjyqësore e

cila përbën edhe parakushtin *sine qua non* për zgjidhjen e çështjes në fjalë, por në thelb, KPP gjykon se, veprimet e mësipërme përbëjnë *veprime procedurale* të cilat nga *lex generalis*, ligji nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” rregullohen në një seksion të vecantë atë të *Hetimit Administrativ* ku parashikohen edhe veprimet procedurale të mbledhjes së provave. Gjithashtu, KPP konstaton se, në rregullime të posaçme ligjore parashikohen edhe veprime procedurale të bashkëpunimit ndër institucional mes institucioneve të administratës shtetërore. Konkretisht, në Vendimin nr.867 të Këshillit të Ministrave datë 10.12.2014 “Për procedurat e bashkëpunimit në institucionet e administratës shtetërore”, i ndryshuar në kreun II pika 6 gërma “dh” parashikohet se: “Kur kërkesa bëhet nga institucionet, njësitë e drejtpërdrejta të ofrimit të shërbimeve apo agjencitë autonome, në varësi të një ministrie, ose administrata e prefektit, drejtuar institucioneve, njësitë të drejtpërdrejta të ofrimit të shërbimeve apo agjencive autonome, në varësi të ministrive të tjera, si dhe administratës së prefektit, afati për kthimin e përgjigjes është deri në 3 (tri) ditë pune për kërkesat e klasifikuara si urgjente dhe 12 (dymbëdhjetë) ditë pune për kërkesat e klasifikuara si të zakonshme”. Sa më sipër, referuar metodës së interpretimit sistematik, të vendosjes në harmoni të normave brenda vetë sistemit, rregullat e tjerë të organizimit dhe funksionimit të administratës shtetërore kanë parashikuar se institucionet publike ndërveprojnë në trajtimin e kërkesave me njëra-tjetrën brenda 3 ditëve pune për kërkesa të klasifikuara si *urgjente*, afat i cili përfshihet edhe brenda afatit 7 ditor të trajtimit të ankesave të operatorëve ekonomikë e cila nuk cënon në thelb as garancitë procedurale të kryerjes së verifikimeve të autoriteteve kontraktore zhvilluese të procedurave të prokurimit publik, por njëkohësisht nuk cënon edhe të drejtën procedurale të ankimit si një e drejtë e parashikuar në ligj. Shkeljet e mësipërme procedurale nga ana e autoritetit kontraktor, sjellin si pasojë që operatorët ekonomikë të paraqesin një ankim pranë Komisionit të Prokurimit Publik duke mos u legjitimuar *ratione temporis*, por, nga ana tjetër, operatorët ekonomikë ndodhen para kushteve të njoftimit të pezullimit të afateve të shqyrtimit të ankesave dhe ndërprerjen e tyre, njoftim i kryer me anë të një akti juridik të posacëm (vendim administrativ), i cili deri në momentin e njoftimit të tyre nuk është shfuqizuar, ndryshuar nga vetë institucioni ose nga një organ epror, e për rrjedhojë KPP, bazuar në parimin e sigurisë juridike nuk mund të anashkalojë në vendimarrjen e tij, faktet dhe provat e mësipërme të administruara në fashikullin e shqyrtimit administrativ. Në jurisprudencën e saj Inter Allia, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë në vendimin nr. 12/2014 datë 17.03.2014 është shprehur se “Siguria juridike nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit tek shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin”. Ndërkohë, nga ana tjetër, në cilësinë e një organi *sui generis quai gjyqësor*, KPP nuk mund të shqyrtojë mbi themelin e pretendimeve të operatorëve ekonomikë në kushtet kur me veprimet e tij autoriteti kontraktor ka cënuar procesin në drejtim të rishikimit administrativ duke ndërprerë afatet e ankimit në kundërshtim me *lex specialiss* ligjin për prokurimin publik dhe duke e mbëshetur këtë të fundit në interpretim të gabuar të *lex generaliss* Kodit të Procedurave Administrative.

III.1.8. Komisioni i Prokurimit Publik, bazuar në nenin 64, pika 3 të LPP – së, gjykon se situata e mësipërme për shkak të shkeljes së procedurës së shqyrtimit të ankesave në kundërshtim me ligjin sa më sipër arsyetuar, përbën shkak për anulimin e kësaj procedure prokurimi.

Në nenin 31, pika 2 gërma “d” të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, parashikohet se: “[...] Komisioni, pas shqyrtimit administrativ të ankesës vendos me akt të motivuar:

d) Të anulohet procedurat për shpalljen e kontratës fituese dhe të udhëzojë autoritetin kontraktor për rifillimin e procedurës së prokurimit [...]”.

Gjithashtu, në lidhje me shkeljet e mësipërme proceduriale për të cilat është vendosur edhe për anulimin e procedurës së prokurimit, në mbështetje të nenit 13, 65 e vijues të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, ti propozojë Agjencisë së Prokurimit Publik nisjen e hetimit administrativ mbi shkeljet e konstatuara.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos marrë në shqyrtim ankesën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Argent Daci” p.f. & “Bioproducts” sh.p.k. në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me nr. REF-53221-03-06-2020, me objekt Loti 3 “Blerje mish dhe nënproduktet e tij”, me fond limit 30.846.736 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 17.04.2020, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.
 2. Të mos marrë në shqyrtim ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “MC Catering” sh.p.k. në procedurën e mësipërme të prokurimit.
 3. Autoriteti kontraktor të anulohet procedurën e mësipërme të prokurimit dhe me rihapjen e procedurës të ketë parasysh konstatimet e mësipërme të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik.
 4. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 5. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Argent Daci” p.f. & “Bioproducts” sh.p.k. dhe operatori ekonomik “MC Catering” sh.p.k.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 490 Protokolli
Datë 02.06.2020

Nr. 522 Protokolli
Datë 05.06.2020

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaid Myzyri